

PILOTIM

MBI MONITORIMIN E INTEGRITETIT GJYQËSOR

OBJEKTI: Projekti “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe që zbatohet nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara ka planifikuar për zhvillim disa aktivitete të lidhura me sistemin e drejtësisë. **Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore**, si pjesë të ekspertizës, ka marrë përsipër hartimin e një dokumenti strategjik-administrativ "Mbi Monitorimin e Integritetit Gjyqësor", (në vijim "MIGJ"), dhe pilotimin e tij si fazë eksperimentale. Ky dokument adreson faktorët e impaktit mbi Integritetin Gjyqësor (gjithsej 35 faktorë të njohura nga standardet kushtetuese, ligjore dhe normave e praktikave ndërkombëtare), performancën e kërkuar, realizimin dhe treguesit e matjes, (gjithsej 105 tregues).

QËLLIMI: Me qëllim që Dokumenti MIGJ, të jetë "*veprues dhe i gjallë*", dhe për rrjedhojë i pranueshëm për përdorim, duhet testuar mbi funksionalitetin e tij. Afati, faza ku ndodhet gjyqësori aktualisht, (Këshilli i Lartë Gjyqësor e sapokrijuar me dy muaj veprimtari¹, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë akoma e pakrijuar², Gjykata e Lartë vetëm me 3 gjyqtarë në funksion), lejon në mënyrë të kufizuar testimin e pak faktorëve, që lidhen drejtpërdrejt me tregues realizimi momentalisht, të matshëm, dhe konkretë. Jo çdo indikator i matjes mund të zbatohet, qoftë për shkak të pamundësisë, qoftë dhe për shkak të faktit, se një matje e plotë do të donte kohën e vet dhe qasje të integruar të metodave të matjes mes disa faktorëve. Pilotimi i 4 (katër) faktorëve, nga dokumenti MIGJ, u bë i mundur bazuar në përzgjedhjen dhe nën konsulencën e ngushtë me KLGJ. Treguesit e realizimit dhe të matjes, gjithashtu u diskutuan me përfaqësues të këtij institucioni. Lidhur me nivelin e realizimit, në terma vlerësues, nuk janë përcaktuar njësi matëse, si: "shumë mirë, mirë, mjaftueshëm, aspak", ose "të realizuara plotësisht, pjesërisht, aspak", pasi ky nivel vlerësimi i saktësuar, do të duhej të bazohej në një metodologji tjetër, më vete, për çdo faktor³.

FAKTORËT E PËRZGJEDHUR:

Faktori 1.1 *Pavarësia institucionale e gjyqësorit*

Faktori 2.2 *Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore e gjyqtarëve*

¹ Në 20 Dhjetor 2018, Mbledhja e parë e konstituimit të KLGJ.

² Në Mars 2019, janë përsëritur dhe hapur thirrjet për kandidatë të ILD.

³P.sh. per Efikasitetin mund te perdorej: **Jashtezakonisht efikase/ Shume efikase/ Pothuajse efikase/Pothuajse joefikase/Shume joefikase/Jashtezakonisht joefikase/**. Per kompetencen dhe profesionalizimin: **Jashtezakonisht profesional/ Shume profesional/Pothuajse profesional/Pothuajse joprofesional/Shume joprofesional/Jashtezakonisht joprofesional/**

Faktori 6.3 *Kultura menaxheriale e drejtimit administrativ të Gjykatës dhe standartet e performancës të personelit jogjyqësor, (V.O. pilotuar pjesërisht, vetëm pjesa e drejtimit administrativ të gjykatës)*

Faktori 7.1 *Buxheti dhe procedurat e caktimit të tij*

Faktori 1.1 Pavarësia institucionale e gjyqësorit	
Treguesit e performancës	<p>Pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar si <i>pavarësi thelbësore</i>, (tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit), dhe si <i>pavarësi strukturore</i>. Si pjesë të pavarësisë strukturore konsiderohen njëkohësisht edhe <i>pavarësia organizative dhe financiare</i>⁴.</p> <p>Kushtetuta ka sanksionuar vetqeverisjen e gjyqësorit, përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë⁵.</p> <p>Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj⁶. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi⁷. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit⁸.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së caktuar me ligj⁹.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme: a) harton dhe ndjek zbatimin e politikave për administrimin gjyqësor; b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura, përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë; c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës¹⁰.</p>

⁴ Vendimi nr.25, datë 05.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese

⁵ Neni 147/1 i Kushtetutës

⁶ Neni 135/1 i Kushtetutës

⁷ Neni 136/1

⁸ Ibid, neni 136/a

⁹ Neni 21/1 i ligjit nr.98/2016.

¹⁰ Neni 89 i ligjit nr.115/2016

<p><i>Treguesit e realizimit</i></p>	<p>Pavarësia objektive është e lidhur me funksionimin struktural të gjyqësorit dhe, ka këto nëntregues: - garancitë formale të pavarësisë, të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj; -garancitë formale, që gjyqtarët i binden vetëm ligjit; - metodat formale mbi caktimin e pagave të gjyqtarëve;- mekanizmat formalë për përshtatjen e pagave të gjyqtarëve;- garancitë formale për përfshirjen e gjyqtarëve në zhvillimin e reformave ligjore dhe gjyqësore.</p> <p>Autonomia organizative dhe financiare ka këto nëntregues: - pozita formale e Këshillit të Lartë Gjyqësor; - përputhshmëria me udhëzimet e Rrjetit European të Këshillave Gjyqësorë; - përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor; - ndikimi i gjyqtarëve në vendimet e Këshillit; - Buxheti i Gjyqësorit, amendimet e tij, dhe zgjidhja e konflikteve mbi buxhetin¹¹.</p>
<p><i>Treguesit e matjes</i></p>	<p>Metoda e matjes për standardet e realizimit të pavarësisë objektive dhe subjektive, duhet të fokusohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizimin e kuadrit juridik mbi pavarësinë organizative dhe financiare në raport me situatën faktike organizative dhe financiare, që rezulton për zbatimin e kuadrit juridik të financimit të gjyqësorit nga Kuvendi. - Krahasim mes buxheteve vjetore të miratuara, dhe atyre të kërkuara sipas nevojave. Statistika dhe analiza mbi kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet e legjitimuara dhe pranimi apo refuzimi i këtyre kërkesave, me pretendime të lidhura me ndarjen dhe ballancimin e pushteteve, me pavarësinë e gjykatave, me paanësinë e gjyqësorit. - Sondazhe të opinionit publik mbi perceptimin, që ata kanë mbi pavarësinë e gjyqësorit, sipas standardeve të CEPEJ. - Perceptimi i pavarësisë në sistemin kombëtar sipas opinionit publik, bazuar në Indeksin Global të Shtetit të së Drejtës, 2016. - Raporte të autoriteteve ndërkombëtare mbi pavarësinë, dhe korrupsionin, (politik, financiar) si element varësie.
<p><i>Realizimi faktik</i></p>	<p>Në Kushtetutë është parashikuar se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm ligjit¹². Nga neni 135- 147/ë, janë parashikuar garancitë kushtetuese të emërimit, qëndrimit në detyrë dhe shkarkimit të gjyqtarëve, si dhe institucionet e pavaruara kushtetuese, që menaxhojnë dhe qeverisin gjyqësorin si dhe që propozojnë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve.</p> <p>KLJGJ është institucion kushtetues. Mandatet, kompetencat, përzgjedhja e anëtarëve është përcaktuar po në Kushtetutë. Kuvendi ka zgjedhur përmes një procedure transparente dhe meritokratike anëtarët nga rradhët e jashtë gjyqësorit. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka zgjedhur nga rradhët e veta anëtarët nga vetë gjyqësori.</p> <p>KLJGJ vendos për emërimin, shkarkimin dhe promovimin e gjyqtarëve si pjesë dhe garanci e pavarësisë thelbësore. KLJGJ përbëhet nga 6 anëtarë të gjyqësorit dhe 5 nga jashtë gjyqësorit, duke plotësuar standardin e vetqeverisjes nga vetë</p>

¹¹ Raporti i ENCJ, "Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës", 2017, fq.15

¹² Neni 145.

gjqësori. Po ashtu dispozitat mbi vetqeverisjen e gjyqësorit janë testuar gjatë kontrollit kushtetues dhe disa prej tyre janë shfuqizuar¹³. Ky është një tregues i pavarësisë funksionale të gjyqësorit, i cili përmes shoqatave me anëtarësi mund të ankimojë ose ka ankimuar ato dispozita që bien ndesh me parimet kushtetuese dhe ato të konventave ndërkombëtare.

Kuvendi, në Shkurt 2019, ka miratuar numrin e punonjësve të KLGJ, po ashtu dhe buxhetin, të lidhura me pavarësinë strukturale dhe financiare. (*për më tepër shih faktorin 7.1.*) Po kështu me vendimin nr.12, datë 18.01.2019, KLGJ ka vendosur miratimin e strukturës organizative të administratës së KLGJ.

Niveli i realizimit	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-
	Mire – realizim I arritur	B+ B B-
	mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C
	dobet – arritje e dobet	*D
	deshtim – arritje e pamjaftueshme	F

Faktori 2.2 Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore e gjyqtarëve	
Treguesit e performancës	Etika e gjyqtarit, shkon përtej rregullave ligjore. Megjithatë, ka një unanimitet, mbi thelbin e parimeve bazë të profesionit të gjyqtarit, pavarësisht diferencave, mbi të cilat ai duhet të veprojë: Pavarësia, paanësia, integriteti, përshtatshmëria, barazia, kompetenca dhe kujdesi i duhur ¹⁴ . Pavarësisht se nuk ka norma morale dhe etike të kodifikuara dhe universale për gjyqtarët, ka një proces të vazhdueshëm globalisht që: - afirmon të drejtën ndërkombëtare, sidomos mbi të

¹³ Vendimet e GJK nr.34/2017; 41/2017 dhe nr.78/2017. Me vendimin nr.41/2017, GJK shfuqizoi si të papajtueshëm me Kushtetutën e të nenit 5, të nenit 61, të nenit 103, të nenit 159 dhe të nenit 169, pika 5 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Me vendimin nr.78/2017, Gjykata shfuqizoi pjesërisht vetem nenin 76/2 të ligjit nr.115/2016 "Mbi organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Me vendimin nr. 34/2017, vendosi: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 8; nenit 9, pika 1, germa "c", fjalia e fundit, si dhe pikat 7 dhe 8; nenit 23, pika 10; nenit 26, pika 4, germa "b"; nenit 44, pika 1, germa "c"; nenit 64, pika 5; nenit 78, pika 3, shprehja "nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar "i pamjaftueshëm" dhe pika 5, germa "b", fjalia e fundit; nenit 95, pika 7, shprehja "me një nivel më të ulët sesa "mirë"; nenit 101; nenit 102; nenit 103; nenit 104; nenit 112, pika 1; nenit 141, pika 1, shprehja "në masën që nuk cenon" dhe germat "a", "b" e "c" të kësaj pike; nenit 152; nenit 161, pika 2, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe pika 3; nenit 162, pika 1, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe pika 6, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji"; nenit 164, pika 1, germa "a" dhe pika 2; nenit 167, pika 3, germa "b", shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji"; nenit 168, pika 2, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji"; nenit 169, pika 5, fjalia e fundit dhe pika 6 e këtij neni.

¹⁴ Profesionit gjyqtarit, Rrjeti i Lisbonës, Këshilli i Europës.

https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2_en.asp

	drejtat e njeriut;- një harmonizim të praktikës gjyqësore sidomos mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin;- përpjekje për unifikim të edukimit ligjor të gjyqtarëve mbi zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare. Me rritjen e rëndësisë së rolit të gjyqtarit në shoqëri, po rritet gjithashtu dhe nevoja për kodifikim të deontologjisë së këtij profesioni.				
<i>Treguesit e realizimit</i>	Treguesit e zbatimit të parimeve deontologjike, janë: -ekzistenca e Kodit të Etikës Gjyqësore; - mundësia e trajnimit mbi etikën gjyqësore; - ekzistenca e një organi përgjegjës për dhënien e këshillave mbi çështje dilematike mbi etikën gjyqësore dhe trajtimi i çështjeve me këtë objekt ¹⁵ ; - monitorimi i sjelljes gjyqësore në praktikë; - raportimi mbi sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve ¹⁶ .				
<i>Treguesit e matjes</i>	Krahasim mes normave etike të Kodit të Etikës Gjyqësore me standardet e kërkuara ndërkombëtare, sidomos parimet e Bangalores "Mbi sjelljen Gjyqësore", 2012. Ankesat dhe kërkesat e shqyrtuara për shkelje të etikës gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.				
<i>Realizimi faktik</i>	- Aktualisht ekziston një kod etike për gjyqtarët. Kodi i Etikës miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, datë 8.12.2006, reflekton normat më të mira dhe të gjithë pranuar ndërkombëtarisht të etikës dhe vlerat e gjyqësorit ¹⁷ . - Mundësia e rishikimit dhe ndryshimeve nën dritën e ligjit nr.96/2016, dhe ligjit nr.98/2016 është e rekomandueshme. - Një nga Komisionet e përhershme të KLGJ, është Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, ngritur me vendimin nr.13, datë 18.01.2019 ¹⁸ . - KLGJ ka miratuar në strukturë Zyrën e Këshilltarit të Etikës, sipas kriterëve ligjore të kërkuara, dhe pritet të njoftojë shpalljen e vakancës për këtë pozicion ¹⁹ . Mosngritja dhe funksionimi ILD, aktualisht e bën të pamundur pasjen e statistikave dhe hetimin për ankime ndaj gjyqtarëve për shkelje të normave të etikës ²⁰ .				
<i>Niveli i realizimit</i>	<table border="1"> <tr> <td>Shkelqyeshem – realizim eksepcional</td> <td>A A-</td> </tr> <tr> <td>Mire – realizim I arritur</td> <td>B+ B B-</td> </tr> </table>	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-	Mire – realizim I arritur	B+ B B-
Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-				
Mire – realizim I arritur	B+ B B-				

¹⁵ Neni 4 i Ligjit nr.96/2016 parashikon se: "3. Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

¹⁶ The Bangalore Principles of judicial conduct, confirmed through the ECOSOC Resolution 2006/23, establish ethical standards of judicial conduct and elaborate the principles of independence, impartiality, dignity, equality, competence and orderliness of judges

¹⁷ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf

¹⁸ <http://www.kld.al/vendime/vendim-nr-13-dat%C3%AB-18-01-2019>

¹⁹

²⁰ Këtë lloj procedurë po e kryen KPK SIPAS Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar, ku depozitohen dhe ankime nga publiku.

	Mjaftueshem – arritje e mjaftueshme	C+ C
	Dobet – arritje e dobet	*D
	Deshtim – arritje e pamjaftueshme	F

Faktori 6.3 *Kultura menaxheriale e drejtimit administrativ të Gjykatës dhe standartet e performancës të personelit jogjyqësor*

Treguesit e performancës	<p>Kryetari i Gjykatës, përfaqëson gjykatën dhe gjyqtarët kolegë, siguron funksionimin efektiv të gjykatës, dhe për rrjedhojë dhe rritjen e shërbimeve ndaj shoqërisë, si dhe ushtron aktivitete gjyqësore si gjyqtar.</p> <p>Organet administrative dhe drejtimi administrativ i gjykatës ka disa nivele:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Gjykatës dhe zv/Kryetari. 2. Këshilli i Gjykatës që ngrihet dhe funksionon pranë çdo gjykate. 3. Kancelari i Gjykatës; 4. Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës. <p>Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjykatës për një periudhë 3-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje²¹. Mandati i Kryetarit të gjykatave, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë²². Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate kryhet bazuar në këto kritere: a) aftësitë drejtuese dhe organizative; b) aftësitë e komunikimit²³.</p> <p>Kryetari i Gjykatës, zgjidhet nga KLGJ dhe ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra, lidhur me standartet e ndërveprimit, bashkëpunimit dhe koordinimit me stafin jo- gjyqësor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit; • thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës; • udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin; • verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit; • kryen veprimet dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë; • garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore; • garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të
---------------------------------	---

²¹ Neni 51 i ligjit nr.96/2016.

²² Ibid, neni 52.

²³ Neni 79 i ligjit nr.96/2016.

çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.²⁴

Zv/ Kryetari i Gjykatës në mungesë të kryetarit, ushtron kompetencat e tij. Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.²⁵

Këshilli i Gjykatës, përbëhet nga tre anëtarët :a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) kancelari i gjykatës dhe ka këto kompetenca: a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës; b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në këtë ligj; c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë; ç) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; d) shqyrton ankesa në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës, shërbimet ndihmëse në gjykatë dhe çështje të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrave të administratës gjyqësore dhe i raporton Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi ankesat dhe masat e marra në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; dh) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin e përgatitur nga nëpunësi i financës, përpara 15 ditëve të paraqitjes në Këshillin e Lartë Gjyqësor; e) jep informacion, mendime ose raporte të kërkuara nga institucione shtetërore sipas ligjit; ë) bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për çështje që lidhen me formimin fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë; f) organizon rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë; g) miraton rregulla të veçanta të gjykatës për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë²⁶.

Kancelari emërohet nga KLGJ,²⁷ dhe është organ përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor dhe ka gjithashtu një sërë kompetencash të rëndësishme²⁸.

²⁴ Neni 37 i ligjit nr.98/2016

²⁵ Ibid, neni 26/2

²⁶ Neni 27 dhe 39

²⁷ Ibid neni 59: Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjorështë Këshilli i Lartë Gjyqësor.

²⁸ Ibid, kompetencat neni 39: Kancelari është përgjegjës për: a) funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave;b) dorëzimin e raporteve periodike për gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve Këshillit të Lartë Gjyqësor; c) raportimin pa vonesë Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve; ç) udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës;d) i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë qasje në të dhënat statistikore për aq sa u nevojitet këtyre institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre të caktuara me ligj;dh) kryen çdo detyrë, siç përcaktohet me ligj ose siç autorizohet nga kryetari.

	<p>Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme: a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë; b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës²⁹.</p> <p>Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person³⁰.</p>
<p><i>Treguesit e realizimit</i></p>	<p>Proceset dhe operacionet e punës³¹ në gjykata duhet të mundësojnë që procedurat gjyqësore të avancojnë, duke respektuar afatet ligjore. Shpërndarja dhe menaxhimi i çështjeve/delegimi i përgjegjësive, duhet të lejojnë standarde performance, efikasiteti dhe eficence.</p> <p>Tregues të realizimit: Ekzistenca dhe zgjedhja e kryetarëve dhe zv/ Kryetarëve në gjykata; ekzistenca dhe krijimi i Këshillave të Gjykatave; - realizimi i Mbledhjeve të Përgjithshme të Gjykatës, sipas përcaktimeve ligjore; - ekzistenca dhe emërimi i kancelarëve dhe stafit jo - gjyqësor sipas përcaktimeve ligjore mbi numrin dhe kompetencën e tyre.</p>
<p><i>Treguesit e matjes</i></p>	<p>Standardet e kulturës menaxheriale, mund të maten përmes analizimit të detyrave të përcaktuara administrative për çdo organ administrativ në cilësi dhe rol menaxherial, Kryetari i Gjykatës, zv/Kryetari, Këshilli i Gjykatës, Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës.</p> <p>Standardet e performancës së personelit jo- gjyqësor, mund të bëhen të matshme, përmes disa indikatorëve, si pyetësorë dhe anketime vetvlerësuese brenda stafit jogjyqësor të gjykatës. Është e lidhur me sjelljen organizative dhe elementët strukturalë të brendshëm dhe standardet e SATURN mund të përdoren si orientim për matjen e nivelit të menaxhimit të brendshëm³².</p> <p>Kultura menaxheriale e kryetarit të gjykatës matet përmes treguesve ligjore dhe vlerësimit të punës menaxheriale si kryetar gjykate sipas standardeve të CEPEJ.</p>

²⁹ ibid, neni 41

³⁰ Neni 8 i ligjit nr.98/2016

³¹ Checklist for promoting the quality of Justice and the Courts/CEPEJ (2008)2

³² CEPEJ-SATURN(2015)2

<p>Realizimi faktik</p>	<p>- KLGJ ka filluar procesin e emërimit të kryetarëve të Gjykatave, në rastet kur ky pozicion ka qenë vakant, sipas procedurës së përcaktur në nenin 52 të ligjit nr.96/2016³³.</p> <p>- Ka filluar organizimi dhe menaxhimi për përzgjedhjen për postet e zv/kryetarëve, Këshillat e Gjykatave të përbërë nga 3 gjyqtarë në çdo gjykatë, organe këto të reja sipas ligjit nr.115/2016. Deri tani janë zgjedhur zv/kryetarët e pothuajse të gjitha gjykatave, dhe Këshillat e Gjykatave janë në përfundim e sipër procesit të krijimit³⁴.</p> <p>- KLGJ, me vendimin nr.17, datë 29.01.2019, ka miratuar listën emërore të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020³⁵.</p> <p>- KLGJ është në procesi të draftimit të 3 rregulloreve, lidhur me rregullat dhe procedurat e kandidimit në Gjykatë të Lartë, nga kategoria e magjistratëve dhe jo- magjistratë. Më pas, pritet procesi i shpalljes së vendeve vakante për anëtarët e Gjykatës së Lartë³⁶, e cila në Mbledhjen e Përgjithshme zgjedh dhe Kryetarin e saj³⁷.</p>											
<p>Niveli i realizimit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="381 823 982 913">Shkelqyeshem – realizim eksepcional</td> <td data-bbox="982 823 1177 913">A A-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="381 913 982 1045">Mire – realizim I arritur</td> <td data-bbox="982 913 1177 1045">B+ B B-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="381 1045 982 1136">Mjaftueshem – arritje e mjaftueshme</td> <td data-bbox="982 1045 1177 1136">C+ C</td> </tr> <tr> <td data-bbox="381 1136 982 1186">Dobet – arritje e dobet</td> <td data-bbox="982 1136 1177 1186">*D</td> </tr> <tr> <td data-bbox="381 1186 982 1276">Deshitim – arritje e pamjaftueshme</td> <td data-bbox="982 1186 1177 1276">F</td> </tr> </table>		Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-	Mire – realizim I arritur	B+ B B-	Mjaftueshem – arritje e mjaftueshme	C+ C	Dobet – arritje e dobet	*D	Deshitim – arritje e pamjaftueshme	F
Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-											
Mire – realizim I arritur	B+ B B-											
Mjaftueshem – arritje e mjaftueshme	C+ C											
Dobet – arritje e dobet	*D											
Deshitim – arritje e pamjaftueshme	F											
<p>Faktori 7.1 Buxheti dhe procedurat e caktimit të tij</p>												
<p>Treguesit e performancës</p>	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe sistemi gjyqësor financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit ku diskutohet projektbuxheti i sistemit gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të</p>											

³³ <http://www.kld.al/vende-vakant>

³⁴ Sipas informacionit të marrë nga takimi me përfaqësues të KLGJ, datë 20.03.2019.

³⁵ <http://www.kld.al/vendime/content/85-v2019/>

³⁶ neni 136 I Kushtetutës

³⁷ Sipas informacionit të marrë nga takimi me përfaqësues të KLGJ, datë 20.03.2019.

	<p>sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor, pranë KLGJ ka këto kompetenca kryesore:a) studion dhe përcakton nevojat për buxhet të të gjitha hallkave të gjyqësorit në bashkëpunim me sektorët financiarë të gjykatave të të gjitha niveleve;b) përpunon treguesit financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave;c) kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.</p> <p>Drejtoria e Auditimit të Brendshëm realizon auditimin e buxhetit gjyqësor. Struktura e KLGJ ka parashikuar 5 punonjës. Kjo drejtori ushtron kompetencat e auditimit dhe monitorimit të përdorimit të fondeve të akorduara për të gjitha gjykatat e vendit, duke filluar nga Gjykata e Lartë, e apelit dhe të shkallëve të para.³⁸</p>
<p><i>Treguesit e realizimit</i></p>	<p>Realizimi duhet të orientohet nga përgjigjet, bazuar në këto pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat janë parimet e financimit të gjykatave? - Si bëhet shpërndarja e buxhetit nëpër gjykata? Si identifikohen nevojat? - A ka trajnime mbi mënyrën e menaxhimit të buxhetit për Kryetarin e Gjykatës? - Si planifikohet fillimisht buxheti i Gjykatës, mbi bazën e cilave kritere, procedurave, dhe cilat janë hallkat e përfshira, (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, strukturat nga gjyqësori)? - A merren parasysh pikëpamjet e gjyqtarëve në hartimin e buxhetit? - Kush ka kompetencën ligjore për menxhimin e buxhetit? - Pas alokimit të buxhetit për çdo gjykatë, si ndodh kontrolli financiar? - Si ndodh llogaridhënia dhe kontrollohet transparenca për përdorimin e ligjshëm dhe eficient të buxhetit të gjykatës?
<p><i>Treguesit e matjes</i></p>	<p>Përdoren të njëjtat metodologji, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të menaxhimit dhe auditimit të buxhetit publik.</p>
<p><i>Realizimi faktik</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Është krijuar dhe funksion Njësia e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, (ish-ZABGJ). - Është miratuar struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me 5 punonjës, e cila ka kompetenca audituese mbi buxhetin e gjyqësorit. - KLGJ ka kërkuar 145 punonjës dhe nga Kuvendi i janë miratuar 125 për administratën e KLGJ. - Buxheti i kërkuar për vitin 2019 nga KLGJ, është 3,211 milion lekë, kurse buxheti i alokuar është 2,380 milion lekë. - Për administratën e gjykatave duheshin 300 punonjës sipas standardeve ligjore³⁹, në fakt janë kërkuar 83 punonjësve dhe janë miratuar nga Kuvendi 20 punonjës. - Shpërndarja e fondeve buxhetore për pushtetin gjyqësor, bazohet në: numrin organik të punonjësve për çdo njësi gjyqësore, numrin e çështjeve të gjykuara, (<i>cost per case</i>), realizimin faktik të njësisë në vitin parardhës, standardet për zërat

³⁸ <http://www.parlament.al/Files/Projekte/20190130150047KLGJ.pdf>

³⁹ Në fakt KLGJ është mbështetur dhe tek standardet e CEPEJ, ku për një gjyqtar duhen 3.5-3.9 punonjës, kurse aktualisht treguesi në sistemin shqiptar është 2.3 punonjës administrate për gjyqtar, dhe me numrin shtesë që ka kërkuar KLGJ, pra 83 punonjës do të shkonte në 2.5 punonjës për gjyqtar.

	kryesorë të shpenzimeve operative, ndërsa dhe për investimet, rinovimi i pajisjeve elektronike në gjykata, në përputhje me database të përgatitur nga USAID dhe ZABGJ ⁴⁰ .	
<i>Niveli i realizimit</i>	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-
	Mire – realizim I arritur	B+ B B-
	Mjaftueshem – arritje e mjaftueshme	C+ C
	Dobet – arritje e dobet	*D
	Deshtim – arritje e pamjaftueshme	F

KONKLUZIONI: Faktorët e pilotuar, tregojnë në një masë *tepër të moderuar*, plotësimin e standardeve të kërkuara për një gjyqësor me integritet. Gjithsesi, treguesit e realizimit duhen marrë me rezervë, pasi dhe metodat e matjes të rekomanduara, nuk janë aplikuar të gjitha, qoftë për pamundësi objektive, të natyrës strukturale dhe normative të kuadrit rregullator veprues, por edhe mjaftueshmëri të kohës në dispozicion për ekspertët e ISPL. Duke qenë se periudha e vënies në zbatim të detyrimeve dhe kërkesave ligjore për reformën në sistemin e drejtësisë do të dojë kohë, është e vështirë të vlerësosh realizimin e disa standardeve në mënyrë përfundimtare, (p.sh. *pavarësia institucionale*), ndërsa disa të tjera për vetë karakterin e faktorit janë të tilla që monitorohen në vazhdimësi, në varësi të fazës së përcaktuar për monitorim, (p.sh. eficaenca e gjykatës, 3- mujore, 6 mujore, vjetore, ose eficaenca e gjyqtarit, etj).

Duhet patur parasysh dy aspekte për pilotimin e faktorëve:

1- aspekti i parashikimit në Kushtetutë dhe në ligj të institucioneve, garancive dhe vlerave kushtetuese të pavarësisë dhe integritetit gjyqësor, si dhe të treguesve të matjes së këtyre vlerave⁴¹;

2- aspekti i zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Aspekti i parë, i parashikimit në ligj është plotësuar tashmë në pjesën më të madhe nga ligjet e hartuara nr.96/2016, nr.98/2016 dhe nr.115/2016. Aspekti i zbatimit është sfida kryesore, që duhet monitoruar, sipas tregueve të matjes, që masin zbatimin e realizimit të faktorëve.

REKOMANDIME:

- **Testimi i 4 faktorëve tregon se nevoja për monitorim të Sistemit të Drejtësisë, dhe diagostikim të gjendjes së integriteti gjyqësor, është e madhe, edhe pse asnjë matje dhe**

⁴⁰ Sipas informacionit dhe dokumnetacionit të marrë nga takimi me përfaqësues të KLGJ, datë 20.03.2019.

⁴¹ <http://www.reformanedrejttesi.al/>

sistem vlerësimi të: 1) pavarësisë dhe paanshmërisë, 2) kohëzgjatjes së procedurave, 3) kompetencës së gjyqtarëve, 4) trajtimit të palëve në seancat gjyqësore, 5) aksesit në drejtësi, 6) integriteti (7) besimi i publikut, nuk mund të realizohet pa patur të dhëna statistikore, si dhe sistem të besueshëm, të saktë, të menaxhimit të çështjeve dhe informacionit gjyqësor.

- **Testimi i 4 faktorëve tregon** se testimi i plotë i 35 faktorëve, pra zbatimi i MIGJ, është i pamundur për momentin, për shkak të riorganizimit të gjyqësorit në nivel organizativ, administrativ dhe struktural.
- **Testimi i 4 faktorëve vlen** për më tepër, për të marrë feedback-un e aktorëve të përfshirë, mbi suksesin potencial të monitorimit të gjyqësorit mbi 35 faktorët, për të ardhmen.
- **Testimi i 4 faktorëve evidentoi**, se indikatorët e realizimit janë përcaktuar në mënyrë të saktë në MIGJ, por jo të plotë.
- **Testimi i 4 faktorëve siguroi** se ka vend për përmirësim dhe shtim të treguesve të realizimit në dokumentin MIGJ, dhe eksplorim të treguesve të matjes.

PILOTIM MBI MONITORIMIN E INTEGRITETIT GJYQËSOR

OBJEKTI: Projekti “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe që zbatohet nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara ka planifikuar për zhvillim disa aktivitete të lidhura me sistemin e drejtësisë.

Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore, si pjesë të ekspertizës, ka marrë përsipër hartimin e një dokumenti strategjik -administrativ "Mbi Monitorimin e Integritetit Gjyqësor", (në vijim "MIGJ"), dhe pilotimin e tij si fazë eksperimentale. Ky dokument është një agregat konceptesh ashtu si dhe vetë "integriteti", dhe adreson faktorët e impaktit mbi Integritetin Gjyqësor, (gjithsej 35 faktorë të njohura nga standardet kushtetuese, ligjore dhe normave e praktikave ndërkombëtare), performancën e kërkuar, realizimin dhe treguesit e matjes, (gjithsej 105 tregues).

QËLLIMI: Dokumenti metodologjik MIGJ ka për synim t'i ofrohet në përdorim kryesisht Organizatave të Shoqërisë Civile, por edhe aktorëve të tjerë të përfshirë në vendimmarrjen mbi gjyqësorin, për monitorimin në vazhdimësi të integritetit gjyqësor, sipas mjeteve dhe metodave të sugjeruara në të. Ky dokument, ofron një metodologji shkencore për matjen e integritetit në gjyqësor, dhe do të konsultohet dhe me menaxherët dhe politikbërësit e gjyqësorit, me qëllimin legjitimimin e tij dhe përdorimin në të ardhmen afatgjatë.

Pilotimi i 5 faktorëve, nga dokumenti MIGJ, pjesë e kapitullit "Transparenca dhe pjesëmarrja aktive", u bë i mundur bazuar në testimin pranë Gjykatës së Lartë. Treguesit e realizimit dhe të matjes, gjithashtu u diskutuan me përfaqësues të këtij institucioni. Lidhur me nivelin e realizimit, nuk janë përcaktuar njësi matëse, si: "shumë mirë, mirë, mjaftueshëm, aspak", ose "të realizuara plotësisht, pjesërisht, aspak", pasi ky nivel vlerësimi i saktësuar, do të duhej të bazohej në një metodologji tjetër, më vete, për çdo faktor, në varësi të qëllimeve dhe objektivave të projekteve përkatëse, për të ardhmen.

FAKTORËT E PËRZGJEDHUR:

Faktori 3.1 *Aksesi në një drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun*

Faktori 3.2 *Aksesi i publikut dhe shtypit/mediave në procedurën gjyqësore dhe në sallat/ambientet gjyqësore*

Faktori 3.3 *Aksesi në vendimet gjyqësore (arkivat, data-base) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën*

Faktori 3.4 *Arsyetimi i vendimeve gjyqësore*

Faktori 3.5 *Gjenerimi i informacioneve dhe zgjidhja efektive e problemeve të pjesëmarrjes, për palët, publikun dhe shtypin*

Faktori 3.1 <i>Aksesi në një drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun</i>	
Treguesit e performancës	<p>Standardet kushtetuese⁴² dhe ligjore të aksesit të informacionit gjyqësor dhe administrativ⁴³, praktikat kombëtare Shqiptare institucionale, dhe standartet ndërkombëtare të deklaruara⁴⁴ kërkojnë akses efektiv të palëve të interesuara, por edhe të publikut në informacion.</p> <p>Garantimi i aksesit, kërkon të drejtën për të aksesuar dokumentacionin gjyqësor⁴⁵, dhe të drejtën për të aksesuar, (për të parë dhe marrë një kopje), të çdo lloj informacioni/rekordi/rregjistri gjyqësor, përfshi edhe atë jo - dokumentar dhe që e tejkalon thjesht një "dosje gjyqësore". Për aq sa është e mundur, gjykatat duhet t'i ofrojnë shërbimet e tyre ndaj palëve ndërgjyqëse, përmes përdorimit të teknologjive të reja.⁴⁶ Gjykatat duhet të intensifikojnë përdorimin e rrugëve elektronike të komunikimit me publikun.⁴⁷</p> <p>Çdo person duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat. Çdo person ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t'i</p>

⁴² Neni 23, prg.1 dhe prg.2 të Kushtetutës

⁴³ Neni 339/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 26 i Kodit të Procedurës Civile; Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"

⁴⁴ Janë afirmuar nga Gjykatat, Kushtetutat, Traktatet ndërkombëtare, (neni 10 i KEDNJ, neni 11 i Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore të BE-së, etj)

⁴⁵ Rregullorja nr.1049/ 30 Maj 2001 e (KE) "Mbi aksesin e publikut në dokumentacionin e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Evropian"

⁴⁶ Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja

⁴⁷ Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja

	<p>drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore. Gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase⁴⁸.</p> <p>Ligji nr. 115/2016 ka parashikuar që Këshilli të caktojë një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, ashtu si dhe të caktojë të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.</p>
<i>Treguesit e realizimit</i>	<p>Mënyra e zbatimit të këtyre standardeve në nivel stafi administrativ të gjykatave dhe në nivel institucional nga gjykata.</p> <p>Treguesit objektivë të transparencës së gjyqësorit: - ekzistenca e mekanizmave transparentë për menaxhimin e çështjeve; -përmbajtja e mekanizmave për menaxhimin e çështjeve; - procedura e ankimit me mundësinë e pjesmarrjes nga jashtë në këtë procedurë; - qëllimi i procedurës së ankimit; - apelimi i vendimit pas ankimit; - numri i ankimeve.</p> <p>Raporte periodike të gjyqësorit me këto nëntregues: - raporte vjetore; - publikim i raporteve vjetore; -qëllimi i raporteve vjetore; - marrëdhënie me Mediat me këto nën tregues: shpjegime të vendimeve gjyqësore në Media;- udhëzime të disponueshme mbi marrëdhëniet me Median;- raportim i çështjeve nga Mediat-caktimi i gjyqtarit për median pranë çdo gjykate apeli.</p>
<i>Treguesit e matjes</i>	<p>Metoda e matjes së standardit të transparencës, arrihet duke vlerësuar kuadrin juridik shqiptar mbi transparencën, duke monitoruar praktikën administrativo-gjyqësore Shqiptare lidhur me aksesin në informacion dhe dokumentacion në krahasim me standardet e kërkuara ligjore.</p> <p>Monitorime dhe matje sipas metodologjive të njohshme dhe të eksploruara tashmë, përmes një sërë indikatorësh, nga subjekte të ndryshme të shoqërisë civile, por edhe Media, dhe prodhim i analizave në drejtim të realizimit të këtij standardi.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me institucionin e pavarur administrativ të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe krijim metodologjie shkencore për matjen e aksesit në informacion sipas standardeve të brendshme dhe ndërkombëtare.</p>
<i>Realizimi faktik, sipas testimit të treguesve të matjes</i>	<p>- Gjykata e Lartë ka krijuar faqen zyrtare online, ku jep mundësinë e njohjes me listën e gjykimeve për të interesuarit ngushtësisht palë në gjykim, por edhe me median dhe publikun e gjerë: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Lista_e_Gjykimeve_5_1.php</p> <p>- Nuk ka pasur deri tani, anketime me përdoruesit, lidhur me transparencën dhe aksesin pranë Gjykatës së Lartë, në mënyrë të që të arrihej në konkluzione mbi nivelin e aksesit sipas përdoruesve të gjykatës, por edhe për transparencën sipas perceptimit publik. Ky pilotim nuk e mundësonte realizimin e anketimeve, as për efekt kohe, as për efekt kostojë financiare.</p> <p>- Përcaktimi i një gjyqtari si komunikus me shtypin, si model që është përqaftuar nga ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor⁴⁹, por edhe nga ligji për organizimin</p>

⁴⁸ Neni 5 i Ligjit nr.98/2016

⁴⁹ Neni 46 i ligjit nr.98/2016.

	<p>e organeve të drejtësisë⁵⁰, akoma nuk ka zhvillime konkrete. Priten rregulloret e KLGJ, por edhe plotësimi i vakancave në GJL, për t'i dhënë zhvillim kësaj kërkesë të ligjit, që në fakt do të ishte dhe tregues më vete i komunikimit profesional me publikun mbi aktivitetet gjyqësore.</p> <p>- Raporte vjetore, me qëllim analizimin dhe bërjen transparente të aktivitetit gjyqësor të gjykatës, <i>de facto</i> për qëllime të brendshme realizohen, sipas konfirmimit nga takimi me përfaqësues të GJL⁵¹, por nuk publikohen për efekt transparence dhe të drejtës për informim të publikut⁵².</p> <p>Gjithsesi KLGJ ka detyrimin e raporteve vjetore sipas ligjit nr.115/2016, ku pjesë të raportimit do të zerë dhe veprimtaria e GJL. Akoma KLGJ, është në vitin e parë të veprimtarisë së saj⁵³.</p>
<i>Niveli i realizimit</i>	(...)
<p>Faktori 3.2 Aksesi i publikut dhe shtypit/mediave në procedurën gjyqësore dhe në sallat/ambientet gjyqësore</p>	
<i>Treguesit e performancës</i>	<p>Aksesi në drejtësi,⁵⁴ fillon me aksueshmërinë fillestare të gjykatave dhe orientimin e court-users, (qytetarëve dhe bizneseve). Vendosja e kontaktit me gjykatat, (go to court), është element i një sistemi drejtësie cilësore, dhe zë fill me disponueshmërinë dhe aksesimin e informacionit në fazën fillestare, (duke inkurajuar përdorimin e IT (e-justice), në mënyrë që nformacioni procedural të jetë i plotë, i saktë, dhe i përditësuar, duke përdorur IT⁵⁵, si një aspekt themelor i garantimit të respektimit të nenit 6 të KEDNJ.⁵⁶ Seanca gjyqësore është publike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe⁵⁷.</p>
<i>Treguesit e realizimit</i>	<p>Efektiviteti dhe praktikiteti i ushtrimit të së drejtës për fillimin e procedurave gjyqësore do të ishte tregues i realizimit të këtij standardi. Lehtësia e përdoruesve të gjykatave dhe garancitë dhe ndihmesa e shtetit për aksesin në një drejtësi cilësore. Treguesit e realizimit, do të duhej të fokusoheshin në pyetje, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ A është i detyruar të shkojë në gjykatë individ i interesuar, apo ka ndonjë alternativë tjetër? ✓ A mund ta ndjekë rastin vetë, apo patjetër duhet një përfaqësues ligjor? ✓ A mund të marrë ndihmë ligjore falas, ai/ajo që e ka të nevojshme? ✓ Kur dhe si duhet t'i paguajë shpenzimet gjyqësore, dhe sa janë

⁵⁰ Neni 91/3 i ligjit nr.115/2016: Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.

⁵¹ Takim i datës 26 prill, pranë GJL.

⁵² Neni 82 i ligjit nr.115/2016:

⁵³ Krijuar në dhjetor 2018.

⁵⁴ Access to Justice “The Courts”, UNODC

⁵⁵ Neni 47 “Shërbimi i teknologjisë së informacionit” i Ligjit nr.96/2016

⁵⁶ Opinioni nr.14, (2011) të CCJE

⁵⁷ Neni 5/3 i Ligjit nr.98/2016.

	<p>ato të vlerësuara paraprakisht?</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ A ka formularë standarte (user-friendly) dhe udhëzime për hartimin dhe depozitimin e padisë, kundërpadisë, ankimin, rekursin etj, dhe ku duhet të paraqitet kërkuuesi për t'i dorëzuar ato? ✓ A ka programe që i drejtohen publikut të gjerë, (outreach) për ta edukuar për vendosjen e marrëdhënieve me gjykatën dhe rolin e tyre? ✓ A ka një kuadër politikash apo rregullator të verifikueshëm dhe që mbikqyret, në lidhje me sa më sipër?
<i>Treguesit e matjes</i>	<p>Metoda e matjes së standardit të transparencës, arrihet duke vlerësuar kuadrin juridik shqiptar mbi transparencën, duke monitoruar praktikën administrativo-gjyqësore Shqiptare lidhur me aksesin në informacion dhe dokumentacion në krahasim me standardet e kërkuara ligjore.</p> <p>Monitorime dhe matje sipas metodologjive të njohshme dhe të eksploruara tashmë, përmes një sërë indikatorësh, nga subjekte të ndryshme të shoqërisë civile, por edhe Media, dhe prodhim i analizave në drejtim të realizimit të këtij standardi.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me institucionin e pavarur administrativ të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe krijim metodologjie shkencore për matjen e aksesit në informacion sipas standardeve të brendshme dhe ndërkombëtare.</p>
<i>Realizimi fakti, sipas testimit të treguesve të matjes</i>	<p>- Rregulla apo norma të posaçme të marrëdhënies së Gjykatës me Median, si dhe ka rregulla për pagimin për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, pritet të parashikohen nga aktet e KLGJ.</p> <p>-Aksesi në salla mendohet si i mjaftueshëm në rastet kur ka interes publik për ndjekje seancash nga qytetarët. Megjithatë, vendosja e monitorëve, plotëson mangësinë në raste të jashtëzakonshme fluksi, duke mos u bërë pengesa për aksesin e publikut⁵⁸.</p>

⁵⁸ Takim i datës 26 prill, pranë GJL.

<i>Niveli i realizimit</i>	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-
	Mire – realizim I arritur	B+ B B-
	mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C
	dobet – arritje e dobet	*D
	deshtim – arritje e pamjaftueshme	F
	<i>Faktori 3.3 Aksesi në vendimet gjyqësore (arkivat, data-base) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën</i>	
<i>Treguesit e performancës</i>	Gjykatat duhet të krijojnë arkiva elektronikë, që do të mundësojnë mbajtjen dhe përdorimin e dokumentacionit elektronik. ⁵⁹ Aksesi në vendimet gjyqësore, (shërbimi i arkivit gjyqësor ⁶⁰) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën duhet të jetë substancial, efektiv, dhe sipas mjeteve më të përshtatshme për kërkuesin. Qendra e dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë , siguron transparencën dhe aksesin on- line të vendimeve të kësaj gjykate ⁶¹ . Të gjitha dokumentat zyrtare duhet të jenë të rregjistruara dhe të publikuara, ndërkohë që duhet të jetë i inkurajuar publikimi në database elektronik.	
<i>Treguesit e realizimit</i>	Treguesit e realizimit, do të duhej të fokusoheshin në pyetje, si: <ul style="list-style-type: none"> ✓ A janë ligjërish të gjitha dokumentat e një “dosjeje gjyqësore” të prezumuara si të aksesueshme nga publiku, me disa përjashtime të vogla dhe ngushtësisht të përkufizuara? ✓ A ekziston kërkesa/detyrimi ligjor për publikimin proaktiv të të gjitha vendimeve dhe opinioneve gjyqësore? ✓ A ekziston një “nëpunës civil” në gjykata, që u përgjigjet kërkesave nga publiku (“fishing for information”), për informacione, që nuk gjenden na database elektronike, dhe që ka detyrimin t’u përgjigjet atyre? 	

⁵⁹ Rekomandimi no. R (2003) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Mbi arkivimin e dokumentave elektronikë në sektorin e drejtësisë".

⁶⁰ Neni 48 i Ligjit nr.96/2016

⁶¹ Neni 35 i ligjit nr.98/2016, sipas të cilit: Qendra e dokumentacionit bën: a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

<p><i>Treguesit e matjes</i></p>	<p>Metodat e matjes, njësoj si tek 3.1.3.</p> <p>Metoda e matjes së standardit të transparencës, arrihet duke vlerësuar kuadrin juridik shqiptar mbi transparencën, duke monitoruar praktikën administrativo-gjyqësore Shqiptare lidhur me aksesin në informacion dhe dokumentacion në krahasim me standardet e kërkuara ligjore.</p> <p>Monitorime dhe matje sipas metodologjive të njohshme dhe të eksploruara tashmë, përmes një sërë indikatorësh, nga subjekte të ndryshme të shoqërisë civile, por edhe Media, dhe prodhim i analizave në drejtim të realizimit të këtij standardi.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me institucionin e pavarur administrativ të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe krijim metodologjie shkencore për matjen e aksesit në informacion sipas standardeve të brendshme dhe ndërkombëtare.</p>										
<p><i>Realizimi faktik, sipas testimi të treguesve të matjes</i></p>	<p>Gjykata e Lartë ka të përcaktuar një kordinator transparence si person përgjegjës për të drejtën e informimit.</p> <p>Kjo gjykatë gjithashtu sqaron të interesuarit, për mënyrat e marrjes së vendimit të arsyetuar përmes, disa metodave:</p> <p>http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendimet_dhe_botimi_i_tyre_60_1.php.</p> <p>Rubrika si të komunikojmë me gjykatën, i vjen në ndihmë çdo personi apo medias, përmes orientimeve të dhëna në të:</p> <p>http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Si_te_komunikojme_me_Gjykatën_e_Lartë_64_1.php</p>										
<p><i>Niveli i realizimit</i></p>	<table border="1" data-bbox="380 1035 1151 1503"> <tr> <td>Shkelqyeshem – realizim eksepcional</td> <td>A A-</td> </tr> <tr> <td>Mire – realizim I arritur</td> <td>B+ B B-</td> </tr> <tr> <td>mjaftueshem – arritje e majftueshme</td> <td>C+ C</td> </tr> <tr> <td>dobet – arritje e dobet</td> <td>*D</td> </tr> <tr> <td>deshtim – arritje e pamjaftueshme</td> <td>F</td> </tr> </table>	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-	Mire – realizim I arritur	B+ B B-	mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C	dobet – arritje e dobet	*D	deshtim – arritje e pamjaftueshme	F
Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-										
Mire – realizim I arritur	B+ B B-										
mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C										
dobet – arritje e dobet	*D										
deshtim – arritje e pamjaftueshme	F										
<p>Faktori 3.4 <i>Arsyetimi i vendimeve gjyqësore</i></p>											
<p><i>Treguesit e performancës</i></p>	<p>Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës⁶².Gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura</p>										

⁶² Neni 142 i Kushtetutës

	<p>ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat, që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.⁶³</p> <p>Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive.⁶⁴</p> <p>Funksion i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë⁶⁵. Neni 6 i KEDNJ detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument.⁶⁶</p> <p>Aspekti i arsyetimit të vendimit gjyqësor vlerësohet, duke u bazuar në tregues të tillë, si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.⁶⁷</p> <p>Një vendim gjyqësor që ka të qartë vetëm dispozitivin është një vendim, që jep vetëm qartësi dhe siguri juridike, vendimi duhet të demonstrojë se a) gjyqtari ka “kuptuar dhe pasqyruar siç duhet rastin e veçantë para tij”, dhe se gjyqtari b) “ka bërë drejtësi ndërmjet palëve”, duke parandaluar konflikte të tjera, dhe kontribuar në harmoninë sociale.</p>
<p><i>Treguesit e realizimit</i></p>	<p>Analiza e vendimmarrjeve gjyqësore nga gjykata më e lartë për më të ultën, sipas pretendimeve procedurale të palëve, është tregues i realizimit të këtij standardi, i cili do të duhej të fokusohet në këto pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ A është arsyetimi i qartë dhe i kuptueshëm⁶⁸, dhe i plotë në lidhje me bazën ligjore, dhe analitik në lidhje me faktet dhe provat që e justifikojnë atë? ✓ A i është përgjigjur gjyqtari në arsyetimin e vendimit të gjitha pretendimeve të palëve, dhe a i ka specifikuar, duke i arsyetuar të gjitha pikat, që e justifikojnë marrjen e vendimit gjyqësor, dhe e bëjnë atë të ligjshëm? ✓ A reflekton vendimi përputhshmëri me parimet e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, dhe GJEDNJ?

⁶³ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009; nr.23, datë 23.07.2009

⁶⁴ *Ibid*

⁶⁵ Vendimi i GJEDNJ në çështjen Hirvisaari kundër Finlandës, 27 shtator 2001, prg. 30

⁶⁶ Vendimi i GJEDNJ në çështjen Van de Hurk kundër Hollandës, 19 prill 1994, prg. 61

⁶⁷ Neni 72/3 i Ligjit nr.96/2016

⁶⁸ Opinioni nr.7/2005 i CCJE

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Sa ankesa dhe rekurse ka bazuar mbi cenimin e këtij standardi nga palët e interesuara? ✓ Sa shpesh vendimi gjyqësor i gjyqtarëve konkrete bëhet i cenueshëm nga gjykatat më të larta, pikërisht për mosplotësim të standardit të arsyetimit? 										
<i>Treguesit e matjes</i>	<p>Metoda e matjes njësoj si tek 2.3.3 më lart. Të dhëna dhe statistika mbi shfuqizimin e vendimeve, nga gjykatat më të larta për ato më të ultat, mbi këtë standard performance, pra arsyetimi i vendimeve gjyqësore.</p> <p>Hulumtim dhe analizë statistikore e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese në drejtim të standardit të arsyetimit gjyqësor.</p> <p>Kontrolli gjyqësor i vendimmarrjes brenda vetë sistemit kombëtar të së drejtës mbi këtë element është standard i realizimit, por edhe i matjes së nivelit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.</p>										
<i>Realizimi faktik, sipas testimit të treguesve të matjes</i>	<p>Mungojnë statistikave me qasje analitike, sipas objektit apo pretendimeve të palëve. GJL prodhon statistika të natyrës numerike, më tepër për efekt organizimi dhe menaxhimi të çështjeve gjyqësore⁶⁹. Ky faktor do të kërkonte statistika serioze dhe kampione studimore të çështjeve të shfuqizuara për shkelje procedurale të standardit të arsyetimit.</p> <p>Studime apo botime të kësaj natyre për vendimet e dhëna prej GJL, lidhur me standardin e arsyetimit nuk ka. Për rrjedhojë nuk mund të matet ky standard performance aktualisht. E njëjta gjë mund të thuhet për vendime të shfuqizuara nga GJK lidhur me këtë standart, si dhe vendime të GJEDNJ, ku është konstatuar shkelje nga GJL për standardin e arsyetimit, për të cilat mungojnë statistikave dhe analizat ndër vite⁷⁰.</p>										
<i>Niveli i realizimit</i>	<table border="1"> <tr> <td>Shkelqyeshem – realizim eksepional</td> <td>A A-</td> </tr> <tr> <td>Mire – realizim I arritur</td> <td>B+ B B-</td> </tr> <tr> <td>mjaftueshem – arritje e majftueshme</td> <td>C+ C</td> </tr> <tr> <td>dobet – arritje e dobet</td> <td>*D</td> </tr> <tr> <td>deshtim – arritje e pamjaftueshme</td> <td>F</td> </tr> </table>	Shkelqyeshem – realizim eksepional	A A-	Mire – realizim I arritur	B+ B B-	mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C	dobet – arritje e dobet	*D	deshtim – arritje e pamjaftueshme	F
Shkelqyeshem – realizim eksepional	A A-										
Mire – realizim I arritur	B+ B B-										
mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C										
dobet – arritje e dobet	*D										
deshtim – arritje e pamjaftueshme	F										

⁶⁹ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Publikimi_i_statistikave_per_vitin_2018_5479_1.php

⁷⁰ Ne çështjen Mullai kundër Shqipërisë, GJEDNJ thekson se: "...ka patur shkelje të parimit të sigurisë juridike sa i përket **mungesës së arsyetimit të njëtrajtshëm** në vendimet e gjykatave vendase lidhur me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit".

Faktori 3.5 Gjenerimi i informacioneve dhe zgjidhja efektive e problemeve të pjesëmarrjes, për palët, publikun dhe shtypin

<p>Treguesit e performancës</p>	<p>Garantimi i transparencës dhe aksesit në informacion gjyqësor si dhe informacion administrativ të prodhuara nga gjykatat. Garantimi i aksesit fizik në sallat e gjykatës për përdoruesit, duke përfshirë edhe ata me problematika të aftësisë së kufizuar fizike. Efektiviteti i zgjidhjes së kërkesave të palëve dhe publikut.</p> <p>Standardet ligjore, kërkojnë që shërbimet për marrëdhëniet me publikun të kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Qëllimi është që: a) t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara; b) t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik; c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik; ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore; d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin⁷¹.</p>
<p>Treguesit e realizimit</p>	<p>Efektiviteti dhe praktikiteti i mundësisë të pjesëmarrjes në procedura gjyqësore do të ishte tregues i realizimit të këtij standardi. Lehtësia e përdoruesve të gjykatave dhe aksesit fizik i sallave gjyqësore, do të ishin tregues realizimi të standardit të aksesit fizik të gjykatave nga të interesuarit. Tregues të realizimit të zgjidhjeve efektive të aksesit fizik, dhe virtual të gjykatave:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Shpejtësia për të gjeneruar një informacion të caktuar ✓ Cilësia e informacionit, nëse është saktë, i rregullt, i përdorshëm, etj ✓ Në trajtimin e kërkesave të palëve dhe të publikut, a ka një përjasje “për të zgjidhur problemet”, apo ka pengesa dhe barriera të pajustificueshme administrative?
<p>Treguesit e matjes</p>	<p>Metodat e matjes 3.1.3. dhe 3.2.3. Matje bazuar mbi monitorime, analiza, statistika dhe të dhënash të gjeneruara nga sistemi, si dhe mbi sondazhe nga përdoruesit e shërbimeve të drejtësisë, sipas standardeve të CEPEJ.</p>
<p>Realizimi faktik, sipas testimi të treguesve të matjes</p>	<p>Faqja zyrtare on line e Gjykatës së Lartë, ofron mundësi informimi, përmes programit të transparencës, për sa vijon: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Programi_i_Transparences_10_1.php Dhënia e informacionit on line, prezumohet se lehtëson komunikimet mes gjykatës dhe publikut të interesuar. Megjithatë analiza apo anketime lidhur</p>

⁷¹ Neni 46 i ligjit nr.98/2016.

	me këtë faktor nuk ka. Informacioni për aktivitetin gjyqësor të GJL, i publikuar online i mjaftueshëm, por problem mbetet ndërveprimi mes GJL dhe gjykatave të zakonshme, ku individit nuk i pranohet nga këto të fundit informacioni i tërhequr online.	
<i>Niveli i realizimit</i>	Shkelqyeshem – realizim eksepcional	A A-
	Mire – realizim I arritur	B+ B B-
	mjaftueshem – arritje e majftueshme	C+ C
	dobet – arritje e dobet	*D
	deshtim – arritje e pamjaftueshme	F

KONKLUSIONI:

- **Testimi i 5 faktorëve tregon** se zbatimi i metodologjisë MIGJ, është i aplikueshëm për monitorimin e integritetit gjyqësor dhe mjetet e propozuara, arrijnë të nxjerrin rezultate konkrete, të matshme dhe të prekshme.
- **Testimi i 5 faktorëve evidentoi** se treguesit e performancës dhe indikatorët e realizimit janë përcaktuar në mënyrë të saktë në MIGJ, por sigurisht ato mund të shtohen apo ndryshohen në të ardhmen, nën dritën e objektivave dhe qëllimeve të projekteve përkatëse.
- Treguesit e matjes, si: sondazhe, anketime, analiza përmbajtësore, statistika dhe analiza statistikore, pra të gjitha metodat sasiore dhe cilësore mbi matjen e performancës, thuhet mungojnë, prandaj dhe pilotimi në Gjykatën e Lartë të standardeve të aksesit të publikut dhe transparencës, nxorri në pah në fakt më tepër se sa praktikitetin dhe funksionalitetin e metodave të matjes, mungesën e theksuar të aplikimit të tyre, për performancën e deritanishme. Për rrjedhojë, fillimi i monitorimit të integritetit gjyqësor sipas mjeteve të parashikuara në të, është domosdoshmëri për të krijuar hapat e para të këtij procesi monitorues, që pa dyshim do të sjellë rezultate të matshme mbi integritetin gjyqësor, si dhe një historik sistematik të dhënash dhe analizash mbi monitorimin e sistemit në terma afatgjatë.